



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0631

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) si dhe nenin 21 dhe 29 të Rregullores së Punës 01/2020 e amendamentuar me datën 09. 08. 2023, në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Eor Group" SH.P.K., kundër Vendimit për kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri-Tender” me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit, më 20/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Eor Group" SH.P.K. me nr. 2023/0631, e datës 29/08/2023, kurse vendimi i AK Komuna e Gjilanit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i dyshemesë të sallës shk. Zenel Hajdini - Ri –Ri-Tender" me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1.
2. **Anulohet**, Njoftimi për kontratë i AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit të sipërcituar, dhe nëse AK ka edhe me tej interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderoj.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Me 03.08.2022, Komuna e Gjilanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë (NJK) dhe dosjen e tenderit (DT), për aktivitetin e prokurimit “Rregullimi i

dyschemesë të sallës shkollës Zenel Hajdini - Ri-Tender”, me numër të prokurimit 651-22-7819-5-2-1.

Me 22.08.2023, AK me të dhëna si më sipër, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka njoftuar GOE “Eor Group” shpk & “Beny Company”.

Me 25.08.2023, OE “Eor Group” shpk & “Beny Company”, nga cilësia e tij/sajë si palë e pakënaqur me vendimin e cituar ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar me Vendimin e AK të datës 25. 08.2023. Me 29.08.2023, “Eor Group” shpk & “Beny Company”, ka ushtruar ankesë në OSHP, kundër vendimit të cituar si më sipër të AK, e cila është evidentuar me numër të protokollit 631/23.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 25.09.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa të aprovohet, si e bazuar;
- Të anulohet njoftimi i AK-se, dhe lënda të kthehet në ritenderim

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se pajtohet pjesërisht me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroj se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesi e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Konstatimet e AK-së lidhur me pretendimet ankimore në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

- *Përgjigja e parë e AK-së*- Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas rivlerësimit të pavarur të tij konstaton se, pretendimi i OE ankues në tërësi është i pabazuar në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në relacion me pretendimet e pohuara se është kundërligjor vlerësimi i AK-së, respektivisht akti i atakuar për eliminimin e tij. Rrjedhimisht, nuk e argumenton me asnjë provë faktin/pohimin bazë se oferta e tij është e përgjegjshme për aktivitetin në fjalë që ka ushtruar këtë kërkesë. Sa i përket pretendimit se, oferta e juaj në vlerësimin fillestar është kualifikuar e suksesshme dhe arsytimit se pas ankesës së juaj e njëjta është aprovuar e bazuar, ju sqarojmë se nga ana e juaj nuk është paraqitur në mënyrë të plotë gjendja faktike sepse lënda është kthyer në rivlerësim për shkak se OE tjerë kanë parashtruar kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftim Vendimit të AK-së të dt. 02.06.2023 e të cilat janë aprovuar. Lidhur me pretendimet e paraqitura duke u mbështetur në vendimet e OSHP-së ne kemi respektuar në tërësi dhe gjatë fazës së ri-vlerësimit të ofertave nga komisioni vlerësues është konstatuar se bazuar në DT dhe Njoftimin për Kontratë sipas Kërkesa 2. Një inxhinier të ndërtimtarisë ose bahchelor Dëshmia 2. Inxhinieri i ndërtimtarisë duhet të dëshmohet me kontrate pune të noterizuar, CV, si dhe OE të prezantoj një Vendim mbi caktimin e inxhinier të ndërtimtarisë. Andaj AK, më datë 02.08.2023, përmes Letrës Standarde Sqaruese ka kërkuar që të sjellni Kontratën e Noterizuar. Ndërsa ju si OE ankues më datë 04.08.2023, lidhur me sqarimin e kërkuar nga AK, nuk keni sjellur Noterizimin e Kontratës ashtu siç është kërkuar në DT, kërkesa 2, dëshmia2, dhe bazuar në LPP dhe RROUPP, oferta e juaj është eliminuar si e papërgjegjshme. Lidhur me Vendimet e OSHP ne kemi vazhduar për rivlerësim por në ofertën tuja janë paraqitur faktet dhe rrethanat të reja me anë të së cilës është konstatuar se oferta e juaj nuk e plotëson kushtin të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale. Me datën 04.08.2023 e kemi pranuar përgjigjen me sqarimet e ofruara nga ana e juaj e cila në shumicën e fakteve dhe rrethanave të shpjeguara nuk ka të bëjë fare me objektin lëndor të kërkesës sipas letrës standarde për sqarim të ofertës. Megjithatë, pas marrjes parasysh dhe analizimit të konstatimeve të pohuara në përgjigjen e juaj në relacion me vlerësimin e tenderit të juaj, AK ka sipas vlerësimit të lirë ka ardhur në përfundim se shpjegimi i juaj nuk është i mjaftueshëm, bindës dhe i bazuar dhe si i tillë nuk e argumenton me asnjë fakt apo provë shpjegimin e situatës faktike për të arsytuar mos noterizimin e kontratës, që e vërteton pohimin e juaj bazë se kinse oferta e juaj është e përgjegjshme. Andaj kjo pikë ankimor është e pabazuar.
- *Përgjigja e dytë (II) e AK-së*- Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, sipas vlerësimit të pavarur të tij konstaton se, pretendimi i OE ankues në tërësi është i pabazuar në asnjë fakt apo provë relevante dhe bazë ligjore në relacion me pretendimet e pohuara. Bazuar në ofertën e OE rekomandues , gjatë vlerësimin dhe krahasimit të ofertave me prezantim të kontratës së inxhinierit bazuar në nenin IV, marrëdhënia e punës është themeluar me kohë të pacaktuar, dhe për piken se kinse nuk është i lajmëruar në ATK ne si AK në DT kemi specifikuar se për cilat kërkesa dhe dëshmi duhet ofruar OE gjatë ofertimit në këtë projekt. Lidhur me pretendimin se kinse nuk e ka të noterizuar kontratën OE rekomandues në ofertën e tij ka ofruar noterizimin e Kontratës nga Noteri me nr.6126/2022, të dt. 12.08.2022. Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit meritor të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të EOR GROUP Sh.p.k., dhe duke u bazuar në analizën e të gjitha fakteve dhe shkresat e kësaj lënde, sipas vlerësimit të pavarur dhe objektiv konstaton se pretendimet e evidentuara në kërkesën e juaj janë të pabazuara në tërësi dhe në këtë mënyrë kërkesa e juaj refuzohet në të gjitha pikat si e pabazuar. Në këtë mënyrë, AK vlerëson se procesi i rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe zbatimit në mënyrë të drejtë të nenit 59.4, nenit 60 paragrafi 1.1 lidhur me nenin 61 (nenin 41 të RRPP dhe me nenin 1, 6 dhe 7 të

LPP.

Pretendimet e Ankuesit

- *Pretendimi i parë (I) ankimor-* Pretendimi kryesorë ankimor sipas ankesë s 631/23 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së komisionit rivlerësues OE: "Eor Group" për inxhinierin e ndërtimtarisë nuk ka ofruar kontratë pune të noterizuar. OE ankues pretendon se të njëjtin kanë ofruar para kontratë me inxhinierin e ndërtimtarisë z.Xhevat Binaku, dhe se kontratën e noterizuar dhe krijimin e marrëdhënies së punës me të njëjtin do ta fillojnë pas nënshkrimit të kontratës mes OE dhe AK-së.
- *Pretendimi i dytë (II) ankimor-* është se për dallim nga OE i rekomanduar për kontratë, OE ankues është i vetmi OE i cili ka vazhduar validitetin e ofertës në mënyrë të vazhdueshme/ pa ndërprerje, dhe se OE duhet të eliminohet. Në vendim të kërkesës për rishqyrtim AK nuk është përgjegjur fare në këtë pretendim ankimor, dhe konsiderojmë se kjo përbën shkelje të rëndë të dispozitave të LPP-së ashtu siç definohet me nenin 97, pika "e" e rregullores 001/2022 për prokurim publik: "*Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues*".
- *Pretendimi i tretë (III) ankimor-* Pretendimi tjetër ankimor është se për inxhinierin e ndërtimtarisë OE i rekomanduar ka prezantuar një kontratë të vitit 2008 ndërsa i njëjti person nuk është në listë të punëtorëve. Ndër të tjera OE ankues pretendon se: "*...Dyshojmë se ky dokument është keqpërdorur nga OE N.N.T Engineering VITI për deri sa nuk gjindet në listë të punëtorëve inxhinieri Emin Rexhepi...*"

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

- *Konstatimi i parë (I)-* Eksperti shqyrtues në rastin konkret vlerëson se problemi nuk qëndron në faktin se OE ka ofruar para kontratë në vend të kontratës, mirëpo problemi qëndron në faktin se para kontrata nuk është e noterizuar. Vlerësimi i ekspertit është se kërkesa për noterizim të kontratës, nënkupton solemnizimin/zyrtarizimin e dokumentit, ku palët në prani të noterit pajtohen për nënshkrimet e dhëna dhe përgjegjësitë dhe obligimet që dalin nga ai dokument, në këtë rast kontrata apo edhe para kontrata. Për më shumë, sipas mendimit tonë noterizimi i para kontratës është edhe më i rëndësishëm se noterizimi i kontratë, pasi në rast të një "kontrate" të punës të pa noterizuar vërtetësia e saj do mund të verifikohet përmes listës së punëtorëve në ATK, listës së pagave etj. Në anën tjetër e vetmja mënyrë për ta formalizuar një "para kontratë" sipas mendimit tonë është noterizimi ose solemnizimi para kontratës konform nenit 41 I ligjit për noterinë "*Solemnizimi i dokumenteve të hartuara nga pala apo përfaqësuesi i tij*". Në rastin konkret vlerësojmë se OE ankues sa I përket kapacitetit Teknik/profesional nuk ka ofruar dëshmi në pajtim me kërkesat e dosjes, jo për faktin se ka ofruar para kontratë në vend të kontratës së punës, po për faktin se para kontrata e ofruar nuk është e noterizuar (nuk është formale). Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i pabazuar.
- *Konstatimi i dytë (II)-* Kjo çështje është trajtuar edhe me raportin e ekspertit nr.97/23, dhe vendimit të OSHP-së nr.97/23 i cili e ka mbështet raportin e ekspertit. Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar.
- *Konstatimi i tretë (II)-* Eksperti shqyrtues pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, fillimisht konfirmojmë se kontrata e z. Rexhepi është e nënshkruar në vitin 2008, ndërsa në letër referencë OE konstaton se z. Rexhepi ka qene menaxher i punëve ndërtimore pjesa hidroteknikës në këtë ndërmarrje në disa projekte nga viti 2008 deri vitin 2020. Megjithatë pas analizimit të mëtutjeshëm kemi gjetur se kontrata e z. Rexhepi nuk është e

noterizuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Për këtë kontratë është ofruar kopja e noterizuar, mirëpo sipas mendimit tonë ne rastin konkret nuk është kërkuar kopje e noterizuar e kontratës, po është kërkuar kontratë e noterizuar, andaj vlerësojmë se dëshmia e ofruar nuk është në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit. Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij se çështja e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit duhet të bëhet për shkak të mungesës së ofertave të papërgjegjshme. Me çrast eksperti shqyrtues i klasifikon si të qëndrueshme pretendimet ankimore të OE ankues kundrejtë OE të rekomanduar për kontratë por si pretendim kryesor që OE ankues eksperti e klasifikon si të papërgjegjshëm, citat i raportit të ekspertit shqyrtues "*Në rastin konkret vlerësojmë se OE ankues sa I përket kapacitetit Teknik/profesional nuk ka ofruar dëshmi në pajtim me kërkesat e dosjes, jo për faktin se ka ofruar para kontratë në vend të kontratës së punës, po për faktin se para kontrata e ofruar nuk është e noterizuar (nuk është formale)*". Andaj, paneli shqyrtues ankesën e klasifikon si pjesërisht të bazuar për faktin se OE ankues, pretendimet ankimore kundrejtë OE të rekomanduar për kontratë i ka të bazuara por pretendimin ankimor të lartëcekur rreth përgjegjshmërisë së ofertës së tij e ka të pabazuar. Kështu që në mungesë të ofertave të përgjegjshme ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet në tërësi.

- Përfundim -

Për shkak të natyrës së këtij aktiviteti të prokurimit dhe nisur nga kompetencat e tija në kuptim të nenit 99 lidhur me nenin 104 dhe 105, Paneli shqyrtues ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore, përfshirë të gjitha veprimet, aktet dhe korrespondencën mes palëve dhe nga ky kontekst mund të kuptohet AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore ashtu siç janë të sanksionuara me nenit 1, 6, 7, 27, 59 si dhe 24, paragrafi 2 i LPP, i cili citon:

"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj."

Nga pikëpamja e këtij Paneli, raporti i ekspertizës përfshinë pretendimet ankimore të palëve, sikurse kërkohet shprehimisht me nenin 114 të LPP në kontekstin e përgjithshëm të vlerësimit të pavarur të secilit pretendim, në raport me natyrën e pretendimit dhe të shkeljeve të pohuara si dhe duke e pasur parasysh qëllimin, përmbajtjen dhe natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vendosjes, Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 1, 6, 7, 24, 27, 59, 103, 104 të LPP-së sipas të cilëve të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

Për pikën 1 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP

Për pikën 4 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Si dhe OE ankues ka arritur me ndryshuar epilogun përfundimtar duke ndryshuar vendimin e AK.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**
- **OE - Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: